| Të dhënat bazë për lëndën | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit** |
| **Programi:** | **Arkitektura e Intrierit dhe Dizajni i Mobilieve** |
| **Titulli i lëndës:** | **Shkathtësi Akademike** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi lëndës:** | **Obligative** |
| **Viti i studimeve:** | **I** |
| **Numri i orëve në javë:** | **3** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **6** |
| **Koha / lokacioni:** | USHAF |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | Prof. Ass. Dr. Bashkim Musliu |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Moduli përqendrohet në teorinë dhe praktikën e të shkruarit dhe komunikimit; ai përfshin edhe shkrimin dhe leximin e punimeve me shkrim gjatë ligjëratave me qëllim që të nxiten diskutimet dhe mendimi kritik. Moduli përfshin studimin e procesit të punimit kërkimor, strukturën dhe aspektin teknik të punimit. Studentët do të nxiten të shkruajnë sa më shumë me qëllim të përplotësimit të kërkesave themelore të lëndës, përkatësisht përplotësimit të realizimit praktik të mënyrës së shkrimit. Ata do të nxiten të komunikojnë dhe të zhvillojnë komunikimin në mënyrë sa më efektive. |
| **Përmbajtja e lëndës** | Moduli përfshin studimin e procesit të punimit kërkimor, strukturën dhe aspektin teknik të punimit.<br>Shkathtësitë akademike në procesin e studimit, shkrimit dhe prezantimit para publikut përbëjnë thelbin e modulit, Përveç kësaj rëndësi e veçantë i kushtohet komunikimit me |

| | |
|---|---|
| | theks të veçantë komunikimit në fushën profesionale. |
| **Qëllimet e lëndës** | Qëllimi kryesor i lëndës është njohja e studentëve me kulturën e shkrimit, kulturën e komunikimit si dhe njohja me nocionet thelbësore të të shkruarit intelektual - akademik. Qëllim tjetër është aftësimi i studentëve për të komunikuar në mënyrë efektive në gjatë aktivitetit të tyre professional. |
| **Rezultatet e pritura** | Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë në gjendje:<br><br>• të njohin procesin e punimit kërkimor;<br>• të dallojnë gjuhën akademike nga regjistrat e tjerë të gjuhës<br>• të komunikojnë në mënyrë efektive;<br>• të kuptojnë rëndësinë e komunikimit në kontekstin organizativ bashkëkohor;<br>• të demonstrojnë shkathtësi në procesin e të shkruarit: gjenerimit të ideve, përgatitjen e drafteve, rishikimin dhe ripunimin e punimeve dhe në prezantime;<br>• të aplikojnë njohuritë që ofron kursi në hartimin e punimeve dhe në komunikim. |

| **Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)** | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithësej** |
| Ligjërata | 3 | 15 | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | | | |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me | 1 | 5 | 5 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| mësimdhënësin/konsultimet | | | |
| Ushtrime  në terren | | | |
| Kollokuime, seminare | | | |
| Detyra të  shtëpisë | 2 | 14 | 28 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 5 | 10 | 50 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 5 | 2 | 10 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 2 | 2 | 4 |
| Projektet, prezantimet , etj. | 5 | 2 | 10 |
| **Totali** | | | **152** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | - Ligjërata (forma e kombinuar – interaktive)<br>- Ushtrime (hartimi i punimeve shkencore, diskutimi i tyre në grupe dhe komunikimi<br>- interaktiv, lidhur me punimet e studentëve)<br>- Diskutime, debate rreth temave të ligjëruara,<br>- Shkrim, interpretim<br>- > Verifikim i dijes përmes testimit, nëpërmjet shkrimit të eseve, seminareve. |
| **Vlerësimi:** | - Vlerësimi i parë 15 %<br>- Vlerësimi i dytë 15 %<br>- Pjesëmarrja aktive në diskutime 10 %<br>- Vijimi i rregullt në ligjërata 10 %<br>- Provimi final 50 %<br>- Totali 100 % |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | • Buisness Communication Today, Bovee/Till, ninth edition. |

| | |
|---|---|
| | • Gjovalin Shkurtaj, Si të shkruajmë shqip, Morava, Tiranë, 2013.<br><br>• Sylivan Barnet, Pat Bellanca, Marica Stubbs, Shkrimi akademik, Dita, Tiranë, 2000. |
| **Literatura shtesë:** | • Boce, Elona Si të shkruajmë një punim kërkimor, CDE, Tiranë, 2004.<br>• Musaj, Bardhyl, Si të shkruajmë ese, "Pegi", Tiranë, 2004.<br>• Nishku, Majlinda, Procesi dhe shkrimet funksionale, QAD, Tiranë, 2004.<br>• |

| **Plani i mësimit:** | |
|---|---|
| **Java** | **Ligjëratat që do të zhvillohen** |
| ***Java e parë:*** | Njohja me përshkrimin e lëndës, metodat, vlerësimin, burimet dhe literaturën. Kultura e gjuhës, kultura e komunikimit dhe shkrimi akademik. |
| ***Java e dytë:*** | Nocionet themelore: gjuha; shkrimi; leximi kritik; shkrimi akademik; drejtshkrimi; drejtshqiptimi |
| ***Java e tretë*:** | Kuptimi dhe rëndësia e komunikimit |
| ***Java e katërt:*** | Lidhshmëria e suksesit me komunikimin në fushën profesionale. |
| ***Java e pestë:*** | Kodet e komunikimit dhe kuptimi i tyre ; parimet e komunikimit efektiiv |
| ***Java e gjashtë*:** | Procesi i punimit kërkimor: zgjedhja e temës; përzgjedhja e literaturës dhe shfrytëzimi i burimeve Hartimi i temës Vlerësimi i parë: rezultatet e esesë tematike |
| ***Java e shtatë:*** | Struktura e një punimi kërkimor (seminari, diploma, magjistratura, doktorata): hyrja; tema (ndarja në kapituj), përfundimi, burimet dhe literatura. |
| ***Java e tetë:*** | Vlerësimi i një eseje<br>Vlerësimi i strukturës së punimit shkencor |
| **Java e nëntë** | Citimi (llojet, mënyrat, format) Fusnota (llojet, format) |

| | |
|---|---|
| *Java e dhjetë* | Burimet dhe literatura (literatura bazë, literatura ndihmëse); Aspektet teknike të punimit kërkimor. |
| ***Java e njëmbëdhjetë*** | Hartimi i një punimi nga fusha e studimit |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | Lektura, korrektura dhe redaktimi |
| ***Java e trembëdhjetë*** | Diskutim lidhur me punimin kërkimor |
| ***Java e katërmbëdhjetë*** | Rekapitullimi i çështjeve kryesore të kulturës së komunikimit |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*** | Rekapitullimi i çështjeve kryesore të shkrimit akademik |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| *Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.* |